

**URDHËR**  
**Nr. 250, datë 18.4.2023**

**PËR MËNYRËN E KRIJIMIT, ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SPITALIT  
DITOR DHE SPITALIT BASHKIAK PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 1, të të nenit 14, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Spitali bashkiak është institucioni shëndetësor me shtretër që ofron kujdes shëndetësor për pacientët e të gjithë grupmoshave, të një ose më shumë bashkive, bazuar në shpërndarjen demografike dhe në planin spitalor rajonal, sipas sistemit të referimit.

2. Spitali bashkiak ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me standartet bazë dhe/ose ato optimale të akreditimit, të protokolleve të diagnozës e të trajtimit dhe udhërrëfyesve, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

3. Spitali bashkiak ofron shërbimet bazë të pranimit dhe menaxhimit të urgjencave mjekësore; pediatrikë; mjekësisë interne, laborator, radiologji, farmaci, si dhe mund të ofrojë edhe shërbime të tjera të specializuara si kirurgji, obstetrikë – gjinekologji, terapi intensive apo subintensive apo të organizojë njësi të veçanta për kujdesin e zgjatur spitalor për rehabilitim apo kujdes paliativ për të sëmurët në fazën terminale të një sëmundjeje, njësi të sëmundjes së transfuzionit sipas përcaktimeve në planin rajonal spitalor mbi shërbimet e nevojshme në territor dhe në varësi të barrës të sëmundshmërisë.

4. Spitali bashkiak siguron vetë ose nëpërmjet një institucioni tjetër shëndetësor furnizimin me gjak dhe nënprodukte të prodhuara nga gjaku.

5. Organi drejtues i spitalit bashkiak dhe atij ditor është drejtoria e spitalit. Drejtoria e spitalit drejton punën teknike, administrative dhe financiare të spitalit dhe përbëhet nga:

drejtori;

zëvendësdrejtori teknik;

kryeinfermieri i përgjithshëm.

6. Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të spitalit bëhet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozim të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Detyrat e drejtorit, zëvendësdrejtorit teknik dhe kryeinfermierit të përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e funksionimit të spitalit.

8. Struktura organizative e spitalit ditor dhe bashkiak miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

9. Rregullorja tip e funksionimit të spitalit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

10. Spitali ditor është spitali që ofron ndihmën e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve dhe realizon diagnostikim, trajtim dhe/ose ndërhyrje kirurgjikale sipas shërbimeve të spitalit të përcaktuara në aktin e ngritjes së spitalit.

11. Tipologjitë e përgjithshme të shërbimeve spitalore që ofron spitali ditor janë të përcaktuara në planin spitalor rajonal dhe shërbimet specifike të përcaktohen në aktin e miratimit të ngritjes së spitaleve.

12. Financimi i spitaleve përfshirë dhe të ardhurat nga tarifat për shërbime klinike dhe joklinike për pacientë jashtë sistemit të referimit bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

13. Spitalet bashkiake dhe ditore, për financimin e shërbimeve shëndetësore dhe aktivitetit, lidhin kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

14. Spitali zbaton mekanizmin e sistemit të referimit të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

15. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor auditojnë, kontrollojnë dhe monitorojnë, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, zbatimin e sistemit të referimit, menaxhimin e buxhetit, vlerësimin e aktivitetit vjetor të spitaleve dhe performancën e spitaleve, sipas treguesve të aktivitetit spitalor, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e financimit.

16. Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ngrihet një grup pune i cili vlerëson statusin e spitaleve aktuale rajonale dhe bashkiake dhe bën propozimet përkatëse sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

17. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Operatori i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe drejtoritë e spitaleve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
**OGERTA MANASTIRLIU**